

20200310592

**LIGJ PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT TE
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM – BANKA
BOTËRORE SIPAS MARRËVESHJES PËR HUA PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
PËR ADMINISTRIMIN E SIGURIMIT SOCIAL**

Neni 1

Republika e Maqedonisë së Veriut merr hua te Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Banka Botërore në shumë prej 13.800.000 eurosh, të dedikuar për realizimin e Projektit për administrimin e sigurimit social.

Neni 2

Kushtet dhe mënyra e shfrytëzimit të huas nga neni 1 i këtij ligji, përcaktohen me Marrëveshje për hua, që do të lidhet ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore.

Në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Marrëveshjen për hua nga paragrafi 1 i këtij neni, do ta nënshkruajë ministri i Financave.

Neni 3

Afati i pagimit të huas nga neni 1 i këtij ligji është 12 vjet, me grejs periudhë të përfshirë prej tre vitesh.

Shkalla e kamatës është EURIBOR gjashtëmujor i rritur për shtrirje fikse.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjea për hua nga neni 2 paragrafi 1 i këtij ligji, Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore provizion të njëhershëm në shumë prej 0,25 % të shumës së huas.

Republika e Maqedonisë së Veriut do t'i paguajë Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – Bankës Botërore provizion në lartësi prej 0,25% të pjesës së patërhequr të huas në nivel vjetor.

Huaja do të paguhet në 18 këste gjysmëvjetore, nga të cilat 17 këste gjysmëvjetore secila në shumë prej 5,56 % të shumës së huas, ndërsa kësti i 18 i fundit në shumë prej 5,48 % të shumës së huas. Huaja do të paguhet më 15 mars dhe 15 shtator çdo vit.

Neni 4

Shfrytëzues i mjeteve të huas nga neni 1 i këtij ligji është Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Neni 5

Republika e Maqedonisë së Veriut huan nga neni 1 i këtij ligji do ta paguajë nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".